

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar i kolegjit, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit A. B., nga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim F. P., av. nga ..., kundër të paditurës Komuna e Obiliqit-Drejtoria Komuna e Arsimit në Obiliq, të cilën e përfaqëson i autorizuari Naim Miftari, objekti i kontestit kthimi në vendin e punës, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4049/16 datë 28.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.6.2018, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4049/16 datë 28.3.2018.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4049/16 datë 28.3.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2550/14 datë 11.7.2016, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës, nr. ..., i datës ..., për mos-ripërtritje të kontratës, vendimi nr..., i datës ..., për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe vendimi ..., i datës ..., me të cilën është refuzuar ankesa e paditësit paraqitur kundër vendimit të ndërprerjes së kontratës së punës si dhe kërkesa që të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës profesor i lëndës së edukatës fizike në shkollën profesionale “H. T.” në ..., me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës,

duke përfshirë dhe kompensimin e të ardhurave personale nga data e largimit deri në kthimin në vendin e punës si dhe të paguaj shpenzimet procedurale.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi në afat ligjor nëpërmjet të autorizuar të tij ka paraqitur revizion për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe ai i shkallës së parë dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ose të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të aktgjykimit të goditur, në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 215 të LPK-së, për ekzistimin e të cilave kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë del se paditësi A. B., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të caktuar, duke filluar nga data ..., deri më ..., në detyrat e punës profesor i edukatës fizike në shkollën profesionale "H.T." në ..., Me njoftimin e të paditurës nr. ..., datë ..., njoftohet paditësi nga e paditura se nuk do t'ia vazhdojnë kontratën për shkak se paditësi se ka dy vende të punës ,mos mbajtjes së orëve dhe performancës jo të mirë. Paditësi kundër njoftimit në fjalë ushtron ankesë, të cilën e paditura me vendimin e saj të datës 28.8.2014 e refuzon.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, me prova të administruara, ka refuzuar kërkesëpadinë duke vlerësuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 70 par. 1 pika 1.4.2 të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës ekziston baza ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit duke vlerësuar se marrëdhënia e punës duhet të interpretohet si marrëdhënie kontraktuese dhe se në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si çështje statusore. Kontrata e punës lidhur në mes të

ndërgjyqësve i referohet dispozitave të karakterit dispozitiv që u jep mundësi palëve të përcaktojnë kushte dhe kohëzgjatjen e kontratës. Meqë paditësi ka pasur kontratën në kohë të caktuar dhe ka qenë si një kusht për kohëzgjatjen e kontratës, e paditura duke pasur arsyet tjera nuk e ka vazhduar kontratën e paditësit dhe të njëjtën e ka ndërprerë për arsye se paditësi ka punuar në dy vende të punës dhe nuk ka pasur performancë të suksesshme.

Gjykata e Apelit duke refuzuar ankesën e paditësit, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuar në tërësi edhe nga gjykata e revizionit.

Pretendimet e paditësit në revizion se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësit ka bërë shkelje nga neni 182 par. 2, pika (n) të LPK, nuk qëndrojnë nga arsyet se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe duke dhënë arsye bindëse dhe të bazuara në ligj. Paditësi nëpërmjet të autorizuarit të tij pretendon se nuk mund të vërtetohet fakti se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të skadimit të punës apo masës disiplinore nuk qëndrojnë nga arsye se që të dy gjykatat kanë dhënë arsye të mjaftueshme se paditësi ka pasur kontratën e punës në kohë të caktuar dhe e njëjta është ndërprerë për shkak të skadimit të kontratës dhe se arsye për shkëputjen e kontratës së punës së paditësit justifikohet me atë se i njëjti ka pasur dy vende të punës dhe se sipas konstatimit të Inspektoratit të Arsimit është gjetur se nuk ka mbajtur orët e rregullta dhe nuk ka pasur performancë të kënaqshme.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës paditësit është bërë në bazë të nenit 67 par. 1.3 të Ligjit të Punës ndërsa si justifikim për këtë ka qenë sjellja e keqe e paditësit si punonjës tek e paditura që jep mundësi punëdhënësit, këtu të paditurës, që paditësit t'ia ndërprejë marrëdhënien e punës të cilën e ka pasur në kohë të caktuar duke u bazuar në nenin 70 par. 1.4.1 dhe se nuk qëndrojnë thëniet e revizionit të paditësit se marrëdhënia e punës së paditësit është ndërprerë në kundërshtim me dispozitat e nenit 67 , 68, 69 dhe 70 të Ligjit të Punës.

Paditësi pretendon se nuk ka punuar me orar të plotë të punës dhe se për këtë ka pasur të drejtë të angazhohet diku tjetër nuk qëndrojnë, nga arsyeja se nga kontrata e punës së paditësit lidhur me të paditurën, nuk mund të konstatohet se paditësi ka punuar te e paditura me orar jo të plotë të punës.

Pretendimet e revizionit sa i përket gjendjes faktike nga gjykata e revizionit nuk janë vlerësuar, për shkak se revizioni nuk mund të paraqitet për shkak konstatimit të gabuar të gjendjes të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe atë sipas nenit 214.2 të LPK.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.201/2018 datë 18.6.2018

Kryetari i kolegjit,  
Erdogan Haxhibeqiri